

FJALA E DEPUTETES ERMONELA FELAJ

E HËNË 31 TETOR 2022

Të nderuar kolegë,

Faleminderit për durimin të gjithë atyre që qëndruan deri në këtë orë të vonë të mbrëmjes!

Gjatë këtij debati u ngrit shpesh nga kolegët e opozitës pyetja: cila ishte vlera e komisionit për reformën administrative-territoriale? Unë besoj se vlera e këtij komisioni, nëse askush nuk e ka kuptuar ende, qëndron pikërisht në sjelljen tolerante që unë gjykoj se një maxhorancë duhet të shfaqë ndaj një minorance. Ky është elementi i demokracisë dhe shfaqet kur pranon kërkesat. Ne e kemi pranuar kërkesën për ngritjen e Komisionit për Reformën Territoriale- Administrative; ju kemi dëgjuar. Në fakt, ky komision ka marrë goxha kohë në dispozicion për t'u dëgjuar dhe ju dëgjuam pikërisht për të pasur këtë ballafaqim publik sot në këtë seancë të posaçme plenare.

Për të hyrë në debatin real, për të cilin jemi ftuar, unë që në krye të herës dua të them që mendova se ky është një nga ato debate ku të duhet të jesh shumë objektiv, të referohesh në argumente sa më pak politike dhe sa më shumë faktike. Unë dhe një pjesë e kolegëve, pa i ndarë qoftë të opozitës, qoftë të maxhorancës kemi pasur rastin jo vetëm të votojmë pro reformës territoriale, por edhe ta prekim nga afër, dal vivo territorin, sipas organizimit që ekzistonte deri në vitin 2015 dhe patjetër besoj se jemi krejt në gjendje që të bëjmë një dallim të qartë midis asaj që ishte territori, shërbimeve në territor dhe asaj që është sot. Në këtë pikë, besoj fort se ky debat do të duhej të fillonte, të paktën për kolegët e opozitës me një prononcim në parim nëse duhej reforma e vitit 2015 apo jo, pa hyrë në detajet e numrave.

Nëse ideja, motivet, justifikimi publik, që legjitimuan atë reformë, do të pranoheshin nga ju sot, do e konsideroja që ky do të ishte një hap minimalisht për të ndërtuar një dialog lidhur me të gjithë atë që mund të reflektohet si përmirësim në legjislacionin dytësor. Këtu kam parasysh referencat që ka bërë raporti i shumicës në Komisionin e Reformës Administrative-Territoriale. Për shembull, një element që besoj se do ta përmirësonte reformën do të ishte pikërisht rishikimi i fshatrave të caktuara, të cilat u janë bashkuar zonave që nuk kanë një lidhje të mirë organike, por nuk e gjej këtë gjë në propozimet tuaja. Sidoqoftë, do të thosha se asnjë llogari elektorale, qoftë kjo afatshkurtër apo afatgjatë, asnjë lloj nxitimi i dikujt nuk mund të jenë arsye të ndryshojnë një reformë kaq të rëndësishme, sepse tek e fundit

nga reforma ose nga ndarja administrative- territoriale kushtëzohet jetesa e komuniteteve. Kur vjen fjala për komunitetet, neve si të zgjedhurit e tyre na takon të jemi jo thjesht të ftohtë, jo të kujdesshëm, por, mbi të gjitha, duhet të jemi të vërtetë.

Po kthehem te qarku, ku unë kandidova për 3 mandate rresht, qarku i Beratit. Është propozuar që aty të shtohet një bashki, bashkia e Shpiragut quhet dhe kjo bashki propozohet të krijohet si rrjedhojë unionit të fshatrave: Sinjë, Velabisht, Tërpan. Unë besoj se këtë mund ta propozonte dikush që nuk e ka shkelur sikur edhe një herë territorin e qarkut të Beratit. Në fakt, përfaqësuesve tuaj në qarkun e Beratit që prej vitit 2009 të paktën, jo thjesht ua kemi harruar ne, kolegët e tyre, emrin, jo thjesht banorët e këtyre zonave ua kanë harruar emrin, por mendoj që edhe ju vetë nuk dini cilin keni pasur dhe cilin keni atje në territor për të ardhur me këto lloj propozimesh.

Katunde, kolegë, ishin qytetet tona deri në vitin 2013; të 373 bashkitë që na latë trashëgimi deri në vitin 2013, ofronin një panoramë, të cilën edhe ju e keni krejt të qartë. Copëtim territori! Po, thuhet në raport me të drejtë. Në 232 njësi jetonin vetëm 20% e popullsisë. Shërbimet ishin të dobëta ose mungonin krejt. Sot një shumicë shërbimesh jepen njëllor si në fshat dhe në qytet. Dihet që tashmë reforma digjitale e ka bërë të mundur këtë gjë pa asnjë dallim. Reforma e ndihmës ekonomike u bë njëllor si për fshatin, edhe për qytetin. Reforma e administratës publike, nga e cila përfitojnë fshati dhe qyteti u bë njëllor pa asnjë diferencë. Ish-komunat ofronin burime të kufizuara njerëzore. Ky mbetet një realitet edhe për sot. Nuk ka ndonjë ndryshim të hatashëm në këtë pikë. Të gjitha këto shkaktonin pabarazi, shkaktonin atë që infrastruktura, minimalisht ajo rrugore, të ishte copë-copë. Kujtoni se si shkohej në Berat deri në vitin 2013, duheshin më shumë se 3 orë, për të mos folur më pas se si shkohej në fshatra dhe qytete të tjera të Shqipërisë.

Ne vendosëm ta bëjmë reformën pikërisht për avantazhet që ajo ofronte. Ndërkohë që riorganizimi i territorit u bë një imperativ, realisht sot, 7 vjet pas implementimit të reformës, ne jemi krenarë që u votua ajo reformë dhe u bë e mundur të ecte përpara. A mund të zhvillohen territoret nëse nuk shihen si një e tërë? Nëse vizioni është i pamundur që të ekzistojë, nëse ti nuk mund të shohësh më larg sesa pragu, se aq territor të është dhënë në administrim, nëse menaxhimi në kuptimin financiar do të vijonte i ndarë, sigurisht, nuk do të zhvilloheshin territoret.

Zonja Denaj u përqendrua shumë gjatë tek elementi financiar, dhe sigurisht që elementi financiar është shumë thelbësor në reformën administrative-territoriale. Ne me reformën ofruam 61 bashki përkundrejt 300 e ca të tillave në territor, ndërkohë që, po ta shikoni me kujdes skemën tuaj të bashkimit, atë që na

propozoni, shihet se ju propozoni një bashki mes të paktën 116 fshatrave për të prodhuar 31 bashki. Pra, bëra një numërim të të gjitha fshatrave, që propozohen të bashkohen mes tyre, për të prodhuar 31 bashki të tjera. Po të ndjekësh modelin tuaj, fshat plus fshat, baras me qytet dhe po të mbash koeficientin 116 fshatra baras me 31 bashki, me rregull 3-shi do t'i binte që për 3020 fshatra që numëron territori ynë, Shqipëria, të dilnim në mesatare, 807 bashki.

Jo, të dashur kolegë, ju kështu e fshini fshatin. Në fakt, ne e duam fshatin. Ne i duam njerëzit që ia dinë vlerën tokës dhe e duan tokën. Ky është fshatari që me siguri nënqesh kur dëgjon tipin e politikanit që vjen këtu në parlament dhe thotë: "Të nderuar qytetarë të fshatit...". Ne duam t'i qëndrojmë thelbit të reformës, pasi gjithçka tjetër që bëme në mbështetje të saj, si ndryshimet që imponuam në ligjin "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin "Për financat e vetëqeverisjes vendore", kanë ndikuar në fuqizimin financiar të bashkive. Ka shumë funksione bazike që iu deleguan bashkive, si shërbimi zjarrfikës, në një vend ku për emergjencat civile renditemi nga më të rrisuarit në Europë.

Arsimi parashkollor sot, një funksion që u është deleguar bashkive, bën të mundur që minimalisht edukatorët e kopshteve të dalin nga portali dhe jo nga portofoli. Mirëmbajtja e rrugëve rurale është një detyrim për të gjitha bashkitë; nuk është një gjë që do të vijojë në mënyrë të shkëputur nga ndryshimi i ngjyrave të bashkive. Edhe pyjet e kullotat administrohen ndryshe. Çfarë të themi për ujitjen dhe për kullimin?! Ne bëme një reformë të tërë për kanalet vaditëse dhe ofruam në dispozicion të të gjitha bashkive një flotë të tërë mjeteve të reja, ekskavatorësh, sipas deklarimeve që bëri çdo bashki në atë kohë për volumin e dherave që duhej të pastronte. Këto janë fakte dhe nuk mund të mohohen. Pastrimi, po ashtu, ka ndryshuar totalisht. Nuk presupozohej më parë që komunat të ndërtonin landfille.

Dhurata, kam shkuar edhe në Dibër dhe më është dukur shumë e bukur Dibra. Reforma ka prodhuar impakte pozitive. Pavarësisht 40 dëgjesave që keni organizuar në komisionin tuaj, pavarësisht disa muajve në dispozicion, orëve të tëra të debatit mediatik, më shumë sesa kaq flet vetë Shqipëria.

Në fakt, ju flisni përmes rrjeteve sociale. Realisht, ndiej kënaqësi kur kolegët tuaj, kolegë tanë ndajnë pamje nga Shqipëria, e cila sot ofron pikërisht ato asete që më parë nuk ekzistonin, nuk i përmendte askush dhe nuk e vuri dorë askush. Ata nuk panë dot përtej non grata-s, por edhe ju, që keni mbetur ende në kohën e katundeve, thjesht sot nuk mund të jeni kritizerët e kësaj reforme. Ora juaj, me propozimin që na bëni, shkon mbrapa dhe fshatit, që zgjohet me të kënduarën e gjelit, nuk mund t'i kërkojmë të njëjtën gjë: t'i çojë edhe gjelat një orë mbrapa. Fshatit dhe qytetit sot i kemi hequr armatën e 6500 këshilltarëve, ku shumica e dimë fare mirë që vegjetonin ose abuzonin, i merrnin pagesat pa i

merituar, i bënin listat e ndihmave ekonomike si t'i dëshironin, vendosnin për bursat që ndante çdo komunë e bashki.

Nga 6500, ku një shumicë ishin vegjetativë, sot kemi vetëm 1595 këshilltarë. Për shpërndarje dhe për të siguruar përfaqësimin, atë që ju e ngritët me të drejtë, besoj se është detyrim i partive politike të sigurojnë një përfaqësim të duhur të të gjitha njësive administrative në këshillat bashkiakë. Nga 14401 punonjës të administratës, pas reformës, mbetën vetëm 9585. Po flas për punonjësit e administratës publike, nuk po flas për punonjësit e ndërmarrjeve që ofrojnë shërbime publike. Nëse rritet numri aty, shumë mirë, sepse do të thotë që ofrojnë shërbime. Ne u kemi dhënë fshatit dhe qytetit, këtu u tha, mundësinë që sot të përfitojnë dyfish nga taksat dhe nga tarifat. Po ashtu, u kemi dhënë mundësi me reforma të kenë trefish investime.

Pra, kolegë, ju propozoni të krijojmë bashki të reja ose të ndërhyjmë në reformën territoriale, por ju siguroj se kjo nuk mund të bëhet sipas formulës fshat plus fshat të na japë qytet, por kjo duhet të bëhet sipas nivelit të përmbushjes së parimeve të njohura të qeverisjes së hapur dhe të autonomisë dhe të një ballafaqimi realist me të gjitha të dhënat në territor. Unë e vlerësoj punën e bërë nga komisioni për faktin e thjeshtë, sepse na riktheu edhe një herë te reforma. Ndoshta jeni ju të parët që keni ofruar një studim të hollësishëm të rezultateve të reformës administrative-territoriale, sepse në Shqipëri nuk ka ende një studim që të na tregojë realisht për këto rezultate.

Prandaj, edhe ne pranuar ta bënim këtë ballafaqim. Unë besoj që 6 orët e këtij debati sot i kanë dhënë mundësi publikut të gjykojë. Çfarë propozoni ju?! Asgjë që vjen në shërbim të publikut. Çfarë propozojmë ne?! Ju ftoj që për ato ndryshime, të cilat janë të nevojshme për të përmirësuar reformën administrative-territoriale, të bëheni bashkë me ne dhe t'i votojmë. Faleminderit!